

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 26.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 1286 prot., datë 03.03.2026, në lidhje me procedurën e konkurrimit me kod #7224, për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Sigurisë Fizike të Informacionit, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, klasa e pagës II-1”, ju informojmë si më poshtë:

Së pari, në lidhje me kërkesën tuaj për vënien në dispozicion të një kopje të vendimit përfundimtar të marrë nga Departamenti i Administratës Publike (DAP) për përfundimin e hetimit administrativ, në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, bashkëlidhur kësaj shkrese, do të gjeni vendimin nr. 4, datë 11.02.2026 të DAP, “Për shfuqizimin e vendimit nr. 36, datë 13.10.2025 të Departamentit të Administratës Publike “Për pezullimin e procedurës së konkurrimit për pozicionin: Drejtor i Drejtorisë së Administrimit dhe Sigurisë Fizike të Informacionit, në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, klasa e pagës II-1, shpallur me kodin 7224”.

Së dyti, për sa i përket kërkesës suaj për dhënien e informacionit mbi bazën ligjore mbi të cilën është vendosur vijimi i procedurës së konkurrimit, ju sqarojmë se DAP është bazuar në nenin 68 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, i cili parashikon se:

“1. Vendimet e ndërmjetme përfundojnë automatikisht në rastet e mëposhtme:

a) përfundon procedura administrative ose mbaron afati, brenda të cilit duhet të ishte dhënë vendimi përfundimtar;

b) kur mbaron afati i caktuar në vendimin e ndërmjetëm;

c) në rastet e tjera të parashikuara shprehimisht me ligj.

2. Organi publik shfuqizon vendimet e ndërmjetme, nëse gjatë procedurës bie shkak i parashikuar në pikën 1 të nenit 67 të këtij Kodi.”

Në këtë kuadër, me rënien e shkakut që kishte diktuar pezullimin e procedurës, DAP ka proceduar me shfuqizimin e vendimit të ndërmjetëm dhe vijimin e procedurës së konkurrimit.

Së fundmi, në lidhje me pretendimin tuaj se keni paraqitur kallëzim penal pranë organit kompetent të prokurorisë për z. D. P. dhe për disa nëpunës të tjerë të AKSIK, sqarojmë se fakti i ekzistencës së një procedimi penal paralel nuk përbën shkak për pezullimin e procedurës administrative. Ngritja e njëkohshme e një çështjeje penale dhe administrative nuk krijon raport përparësie midis tyre, por legjitimon zhvillimin paralel të procedimeve, për shkak të natyrës, qëllimit dhe standardeve të ndryshme që ato ndjekin.

Në këtë drejtim, jurisprudenca e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka konsoliduar qëndrimin se procedura administrative nuk kushtëzohet nga rezultati i procedimit penal. Konkretisht, në vendimin nr. 00-2023-2356, datë 13.06.2023, është theksuar se procedimi administrativ disiplinor konkurren me atë penal dhe se shpallja e pafajshme në procesin penal nuk nënkupton automatikisht mungesën e përgjegjësisë administrative. Gjithashtu, është nënvizuar se përgjegjësia administrative është më e gjerë se ajo penale dhe se vendimi penal ka efekt detyrues vetëm në lidhje me ekzistencën e faktit dhe autorësinë, por jo mbi pasojat administrative.

Ky qëndrim përforcohet edhe në vendimin nr. 00-2023-342(52), datë 13.02.2023, ku është vlerësuar se konkluzionet e procedimit penal nuk kanë efekte detyruese në gjykimin

administrativ dhe se pushimi i çështjes penale nuk përjashton përgjegjësinë administrative. Në të njëjtën linjë, edhe Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 15, datë 22.06.2022, ka pranuar mundësinë e ekzistencës së dy procedurave paralele (administrative dhe penale) për të njëjtën sjellje, duke theksuar se ato kanë natyra dhe objektiva të ndryshme. Referuar nenit 4 të Protokollit nr. 7 të KEDNJ-së, kjo dispozitë nuk ndalon zhvillimin paralel të procedimeve, për sa kohë nuk kemi një dënim të dyfishtë në kuptimin e ngushtë të parimit “ne bis in idem”.

Për rrjedhojë, procedimi penal dhe ai administrativ zhvillohen paralelisht, pa cënuar parimet themelore të së drejtës, për sa kohë respektohen kufijtë dhe qëllimet e secilit sistem përgjegjësie.